



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 126/26 Dt. 19.03.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për lejimin e realizimit të projektit: “Furnizim me veshmbathje për banorët e Shtëpisë Rezidenciale, Shtëpisë së Pleqve dhe Shtëpisë Emergjente për Fëmijë”, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Kontrata do të jetë trevjeçare (kontratë kornizë).
3. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale -mallra dhe shërbime.
4. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.

